



Flauers SHOSHI

Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve

Z. Flauers SHOSHI është diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili Inxhinier Hidroteknik, në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe zotëron gjithashtu një Master në Qeverisje Vendore.

Ai ka një karrierë të gjatë dhe të konsoliduar në sektorin e ujësjetës-kanalizimeve, ku ka nisur si teknik dhe më pas ka vijuar si inxhinier, Kryeinxhinier dhe Administrator i Ujësjetës të Malësisë së Madhe dhe Shkodër Fshat për rreth 14 vite.

Përvoja e tij përfshin edhe angazhime në sektorin privat si këshilltar teknik në fushën e ujit, si dhe pjesëmarrje aktive në institucione dhe organizata të ndryshme të fushës.

Që prej vitit 2019, z. SHOSHI ka shërbyer si Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).

Në qershor të vitit 2025, z. SHOSHI u emërua Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare Ujësjetës-Kanalizimeve, institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ku vijon të kontribuojë me profesionalizëm dhe vizion për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit.